



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.348, datë 25.10.2021

**MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKURORIN
ERJON SHEHAJ, KANDIDAT PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË LEZHË**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159, pika 1 dhe 2 germa "a" dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 52, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në pikën 5, të nenit 9, të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", miratuar me Vendimin nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe në germën "ç", pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, të Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019 e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ndryshuar si dhe pasi u njoh me Relacionin "Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokurorin Erjon Shehaj, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokurorin Erjon Shehaj, kandidat për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatit prokuror Erjon Shehaj të vijojë me procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.
3. Të njoftohet për këtë vendim z. Erjon Shehaj.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**



**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR
MOISI DUDA**